(c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

-shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me

shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të

njëtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1:Formulari i OfertësEkonomike

Shtojca 2:Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca3:Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratëmbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca7:Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit.....

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca9: Formulari i Kriteve te Përzgjedhjes se Ofertuesve

Shtojca10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve tëankimit

Shtojca14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadërpas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15:Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit tëProcedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimetpër **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimevesipas elementëve përbërës të shërbimitdhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeveobjekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

a. Operatori ekonomik duhet të zbatojë kërkesat e Ligjit Nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimorë në ambientet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjenës dhe mjedisit, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

b. Produktet e përdorura për përgatitjen e ushqimeve duhet të jenë në përputhje dhe në respektim të standarteve të kërkuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, konform manualit të vetëkontrollit HACCP .

c. Transporti i ushqimit të përgatitur nga kuzhina e shërbimit të ushqimit social për grupet e vecanta deri te konsumatori, të realizohet me mjete, pajisje dhe enë të posacme (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasisë që ofrohet, si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit (e rëndësishme është ruajtja e temperaturës sipas llojit te produktit).

ç. Produktet ushqimore (lënda e parë) që do të përpunohen, trajtohen apo ambalazhohen në ambientet e përpunimit (kuzhinës) që disponon sipërmarrësi të jenë të shoqëruara me fletë analizën përkatëse.

d. Operatori ekonomik, të respektojë rregullat e higjenës për larjen, pastrimin, dhe përpunimin e zarzavateve, frutave, sipas kërkesave të ligjeve në fuqi në fushën e higjienës dhe ushqimit.

e. Operatori për qëllime higjene dhe pastrimi të përdorë detergjente dhe solucione kimike të certifikuara nga institucionet e njohura me ligj dhe të pa dëmshme për shëndetin e njerëzve të përcaktuara sipas akteve përkatëse konform Urdhërit nr. 365 datë 03.08.2012 i Ministrisë të Shëndetësisë “Për miratimin e listës dhe përdorimin e lëndëve që përdoren për dezinfektim, deratizim, desinsektim në shëndet publik”.

f. Operatori ekonomik duhet të sigurojë një higjene të përditshme në mbajtjen e pajisjeve të kuzhinës, ambienteve të gatimit, atyre të ndarjes së ushqimit dhe mensave, e dokumenatuar kjo me anë të regjistrave të manualit të vetkontrollit (HACCP).

g. Operatori ekonomik duhet të realizojë larjen dhe dezinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren. Pastrimi i inventarit të imët kryhet nga operatori ekonomik, i cili duhet të mbajë dhe regjistrat e pastrimit.

gj. Në rast të sëmundjeve infektive, të përdoren për shpërndarje të ushqimit vetëm paisje të vecanta dhe një përdorimshe. Këto të fundit të pajisur me certifikatën e cilësisë për

përdorim ushqimor ose simbolin për përdorim ushqimor 

h. Operatori ekonomik, do të paketojë dhe të evadojë çdo ditë mbeturinat që krijohen si rezultati prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të ushqimit, në vendet e caktuara si vendgrumbullimi mbeturinash.

i. Materiali në kontakt me ushqimin (termuset, enët, etj, me të cilat transportohet ushqimi) të jenë material i përshtatshëm dhe lehtësisht të pastrueshme, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë të Bujqësisë Nr. 22, datë 25.11.2010 “Kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të higjenës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”, me mbyllje

hermetike (për të siguruar mbrojtjen nga mjedisi i jashtëm). Enët që përdoren për transportin dhe/ose shpërndarjen e ushqimit duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin.

j. Punonjësit e operatorit ekonomik në momentin e përgatitjes/shërbimit të ushqimit në ambjentet e autoritetit kontraktor, duhet të jenë të pajisur me uniformën, veshjen përkatëse të punës (perparëse, grykëse, këpuce, pantallona, kapuca, doreza sipas rastit) këta të fundit të jenë të pajisur me librezë shëndetësore.

k. Operatori ekonomik duhet që në cdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij dhe të garantojë sigurinë e produktit nëpërmjetë gjurmueshmërisë së tij, sipas VKM nr. 760, datë 16.09.2015 “Për kërkesat për gjurmimin e ushqimit dhe ushqimit për kafshë përgjatë zinxhirit ushqimor”, Ligjit Nr 9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, neni 25

l. Operatori i biznesit ushqimor duhet të analizoj ujën në pikën fundore për ngarkesën mikrobike cdo 6 muaj, kjo e dokumentuar me raport prove e leshuar nga institucioni përkatës

m. Operatori ekonomik duhet të kryej shërbimin DDD (Dezinfektim – Dezinsektim- Deratezim) për ambjentet ku ushtrohet aktiviteti cdo 6 muaj e dokumentuar kjo me certifikatën DDD e lëshuar nga kompani e licensuar për këtë aktivitet

n. Operatori ekonomik është i detyruar të ruajë në raftë të vecanta në mjedisin e kuzhinës, kampionet e ushqimit të gatuar e që shpërndahet për ngrënie për të gjitha vaktet. Afati i ruajtjes së mostrave (kampionëve) është 24-orë. Kur ka denoncime për cilësinë e ushqimit, ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.

o. Operatori ekonomik, do të mbulojë shpenzimet ekonomike të nevojshme për realizimin e analizave laboratorike të mostrave të ushqimit gatuar, sa herë që kërkohet nga autoriteti kontraktor.

Menuja për 249 ditë (pune)

1.	Fasule me mish	gram	400	
2.	Pilaf	gram	500	
3.	Qofte	gram	600	
4.	Supë me oriz	gram	400	
5.	Pure	gram	400	
6.	Supë fidhe me perime	gram	800	

7.	Pastice	gram	300	
8.	Turli me mish të grirë	gram	500	
9.	Fileto pule	gram	400	
10.	Eskallop	gram	500	
11.	Gjellë me patate me Mish	gram	500	
12.	Kofsha pule	gram	400	
13.	Makarona me salcë	gram	800	
14.	Nr	Artikulli	Njesia	Norma
15.	Burani me vezë	gram	400	
16.	Specat të mbushur	gram	500	
17.	Tarator	gram	400	
18.	Fërgesë specat gjizë	gram	400	
19.	Kima me vezë	gram	400	
20.	Kunguj me kos	gram	800	
21.	Patëllxhan të mbushur	gram	400	
22.	Makarona me fileto pule	gram	800	
23.	Pastico me eskallop	gram	500	
24.	Bukë	gram	5000	
25.	Ëmbëlsirë	gram	800	
26.	Fruta	gram	1200	
27.	Caj / Kafe	ml	150/50	
	Totali pa TVSH për menu/person me 1 vakt për 249 ditë (pune)			

**Çmimi
pa
TVSH**

Nr.	Emërtimi	Vlera e menuse për 1 person ditë/lekë pa tvsh	Vlera e menuse për 1 person/lekë pa tvsh për 249 ditë (pune)	Nr. Personave	Vlera në total pa tvsh për 249 ditë (pune) për 60 persona
1	Menuja për 1 vakt			60	
TVSH (%)					
Totali me tvsh					

1. Ushqimi ditor do të përmbajë :

- Pjatë e parë 250 g
- Pjatë e dytë 250 g
- Bukë 300 g
- Fruta / Ëmbëlsirë 150 g
- Caj / Kafe 150ml/50ml

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- 1.Vlera për person do të jetë 258 (dyqind e pesëdhjetë e tetë) leke pa TVSH dhe 310 (treqind e dhjetë) lekë/ditë me TVSH)
- 2.Numri maksimal i racioneve të porositura do të jetë jo më shumë se 60 racione.
- 3.Qendra Sociale do të njoftojë në orën 09: 30 për numrin e saktë të racioneve që do të porositen.
- 4.Qendra Sociale do të furnizohet me Caj / Kafe (sipas numrit të kërkuar) nga e hëna në të premte në orën 09:30 pranë ambjenteve të qendrës.

5.Qendra Sociale do të furnizohet me Ushqim të Gatshëm nga e hëna në te premtën në orën 11 :00 pranë ambjenteve të qendrës .

6. Ofrimi i shërbimeve do të kryhet në ambientet e Qendrës sociale “Shtëpia e Përbashkët” Berat.

7. Qendra do të pajiset çdo ditë me një faturë provizore ku do të cilësohen numri i menuve të marra në dorëzim, çmimi si dhe vlera në lekë e ushqimit të sjellë.

8. Çdo pjatë do të përmbaje asortimentet e mëposhtme :

Fasule me mish	Fasule Mish (viçi) Qepë Vaj Ulliri Specatë kuq Kripë	Makarona me salc	Makarona Gjalp Majdanoz Kripë Salc domate
Supë Oriz	Oriz Vezë Lëng Mishi Limon Bulfonyjalp Majdanoz	Turli me mish të grirë	Karrota Patate Specatë Patëllxhan Kripë Piper Vaj Qepë grirë(viçi) Mish i
Supë Frikase	Perime në mix Vezë Limon Gjalp Majdanoz Kripë Piper	Pastiço	Makarona (spageti) Vezë Qumësht Djathkackavall ose Djath i bardhë Gjalp Kripë

Qofte	Mish (viçi) Qepë Vezë Miell Piper Rigon Spec i Kuq Kripë Hurdha	Supë me Perime	Bulfon fidhe Perime të ndryshme Gjalp Piper Majdanoz Kripë
Fileto Pule	Fileto pule Miell Vezë Limon Kripë	Pure	Patate Vezë Limon Kripë
Patëllxhan të mbushur	Patëllxhana Mish i grirë(viçi) Majdanoz Piper Oriz Vaj Ulliri Qepë	Eskallop	Mish Vici Miell Domate Piper Gjalpë
Tarator	Kos Kastravec Hudhra Kripë Vaj Ulliri Erëza	Gjellë me patate me mish të grirë	Patate Kripë Piper Majdanoz Qepë Vaj Ulliri Mish i grirë(viçi)
Kimë me vezë	Mish (viçi) Qepë Vezë Spec Piper Kripë Vaj Ulliri	Kunguj me kos	Kos Kunguj Vaj Ulliri Kripë

Speca të mbushura	Speca Mish i grirë(viçi) Majdanoz Piper Oriz Vaj Ulliri Qepë	Gjellë me patate me mish	Patate Mish (viçi) Qepë Kripë Piper Vaj Ulliri
Fërgesë me specë, gjizë	Domate Gjize Specë Gjalp Vaj Ulliri Kripë Piper	Pilaf	Oriz Gjalp Vaj Ulliri Lëng Mishi
Supë Orientale	Perime të bluara Bulfony Qumësht Gjalp Majdanoz Kripë	Burani me vezë	Spinaq Vezë Limon Gjalp Majdanoz Kripë

Kërkesa të Përgjithshme

1. Operatori ekonomik është i detyruar të zbatojë procedurat e menaxhimit të ushqimit të kërkuara në urdhrin e Titullarit të Autoritet Kontraktor.

-
2. Operatori ekonomik duhet të ketë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin, dhe shpërndarjen e ushqimit, për një grup personash prej 60 veta për vaktin e drekes, sipas orareve të përcaktuara.
 3. Operatori ekonomik të sigurojë e disponojë në guzhinë, mjete matëse të sasisë të certifikuar nga inspektorati i kalibrimit të njësive matëse.
 4. Çdo ditë përfaqësues të operatorit ekonomik do të rakordojnë me personin e ngarkuar nga titullari i Qendres Sociale për hartimin e forcës ditore të ushqimit dhe për konsumin e tij, në Qendrën Sociale.
 5. Operatori ekonomik, nuk mund të transferojë, kalojë pa pëlqimin e autoritetit kontraktor, detyrimet e tij, kontraktuale një pale të tretë.
 6. Operatori ekonomik do të paraqesë në fund të çdo muaji faturën dhe dokumentacionin justifikues për sasinë e mallrave të furnizuar konform kuadrit ligjor në fuqi.

Kërkesa teknike për përgatitjen e ushqimit dhe sigurinë ushqimore.

Siguria ushqimore

1. Të gjithë artikujt ushqimore që do të përdoren për gatim do të jenë të cilësisë së pare, të freskëta, sipas specifikimeve teknike për lëndet e para të përcaktuara në këtë dokument.
2. Ushqimi të jetë i gatuar në çast, racioni ditor duhet të përmbajë sasi të duhura të artikujve sipas menisë ditore/javore, ushqimi të shpërndahet i ngrohtë sipas orareve të përcaktuara nga Administrata e Qendrës Sociale.
3. Në asnjë rast nuk do të lejohet zëvendësimi i artikujve ushqimore, që janë përcaktuar në normën bazë të ushqimit, me përjashtim të rasteve të fatkeqësive natyrore apo të fuqisë madhore.
4. Personeli që do të realizojë procesin e prodhimit të ushqimit, të ketë kualifikimin e nevojshëm profesional, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore.

MENAXHIMI I SHËRBIMIT NGA AUTORITETI KONTRAKTOR

1. Të verifikojë për vaktin e drekes numrin e personave që trajtohen me ushqim (forca ditore) të detajuar: .
 - Numri i personave që trajtohen me një vakt.

-
2. Autoriteti Kontraktor të kontrollojë e ti kërkojë operatorit ekonomik respektimin e orarit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, zbatimin e normave të racioneve të ushqimit, si dhe pastërtinë në ambientet e gatimit të ushqimit dhe të shpërndarjes së ushqimit.
 3. Autoriteti Kontraktor, të mos lejojë operatorin ekonomik që të përdorë pajisje për gatim dhe inventarë të imët për shpërndarjen e ushqimit jashtë specifikimeve të kërkuara në Dokumentet Standarde të Tenderit.
 4. Autoriteti Kontraktor, nëpërmjet komisionit të ngritur me urdhër të titullarit, do të regjistrojë veprimet ekonomike për sasinë e racioneve ditore të prodhuar në ditë të detajuara në numër rendore me një vakt, veprimet për likuidimin e detyrimeve të lindura ndaj operatorit ekonomik do të rregullohen me urdhër të veçantë të titullarit të Autoritetit Kontraktor.
 5. Operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë ditore/javore të ushqimit të miratuar, konform normës bazë të ushqimit.
 6. Menuja e ushqimit do të sigurojë sasinë, cilësinë sipas normës bazë të ushqimit.
 7. Të disponojë mjete transporti të përshtatshme për transport të produkteve ushqimore të freskëta si dhe ato të gatuar, të cilat të plotësojnë të gjitha kushtet higjeno-sanitare sipas standardeve në fuqi.

Programi Ushqimor

1. Sipërmarrësi do të zbatojë planin e menisë ditore dhe javore të ushqimit sipas programit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, gjithsesi sipërmarrësi me miratim paraprak nga Qendra Sociale mund të alternojë servirjen e menuve javore të miratuara nga AK në varësi të përshtatjes sa më të mirë me sezonin dimër / verë.
2. Programi ushqimor do të sigurojë sasinë, cilësinë e duhur të ushqimit. Sasia dhe cilësia e ushqimeve që furnizohen nga sipërmarrësi duhet tu përgjigjen kushteve që përcakton Ligji mbi ushqimin.

Operatori ekonomik duhet të ketë inventarin e nevojshëm për ruajtjen, përpunimin, gatimin, dhe shpërndarjen e ushqimit, për një grup personash prej 60 veta për vaktin e drekës, sipas orareve të përcaktuara.

1. Banjomarina
2. Tabaka -- 60 cope
3. Luge –60 cope
4. Piru – 60 cope

-
5. Tas per supen –60 cope
 6. Pjata gjelle –60 cope
 7. Pjata te vogla -60 cope
 8. Gota uji – 60 cope
 9. Mushama
 10. Letra
 11. Ndarëset e ushqimit (garuzhde etj.)

Shënim: Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

- **Java e I – rë**

Nr.	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
1.	Fasule me mish (viçi)	Supë me oriz	Supë frikase	Supë fidhe me perime	Supë Orientale
2.	Pilaf	Turli me mish(viçi) te grire	Pastico me qofte zgate	Fileto Pule me Pure	Makarona me salce dhe Eskallop
3.	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë
4.	Fruta (portokalle)	Ëmbëlsirë (Puding me cokollate)	Fruta(molle)	Embelsire (Sultiash)	Fruta (Portokalle)
5 .	Çaj /Kafe	Çaj/Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe

- **Java e II- të**

Nr	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
1.	Supë me oriz	Supë frikase	Supë Orientale	Supë me oriz	Supë me perime
2.	Pure me qofte me leng	Specat mbushur	Pilaf me qofte	Gjelle me patate me mish(viçi)	Burani me spinaq e veze
3.	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë	Bukë
4.	Fruta	Ëmbëlsirë (Puding	Fruta	Embelsire	Fruta

	(molle)	mecokollate)	(Portokalle)	(Sultiash)	(molle)
5.	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe

• **Java e III – të**

Nr.	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
1.	Specat mbushur	Supë oriz dhe limon	Ferges,spec agjize	Turli me mish (viçi) te grire	Frikase me kofsha pule
2.	Tarator	Gjelle me patate mish(viçi)	Pilaf	Kima me veze	Eskallop
3.	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke
4.	Fruta (Pjeper)	Embelsire (Kek)	Fruta (Molle)	Embelsire (Puding)	Fruta (Pjeshke)
5.	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe

• **Java e IV – të**

Nr.	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
1.	Supë fidhe me perime	Kunguj me kos	Fasule	Supë me oriz	Supë frikase
2.	Kima me veze	Makarona me fileto pule	Pilaf	Patellxhan te mbushur	Pastico me eskallop
3.	Buke	Buke	Buke	Buke	Buke
4.	Fruta (Pjeper)	Embelsire(Sultiash)	Fruta (Shalqi)	Embelsire (Kek)	Fruta (Pjeshka)
5.	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe	Çaj /Kafe

Afatet e ekzekutimit: Nga momenti i nënshkrimit së kontratës/kontratave, për 249 ditë (pune) brënda afatit të marrëveshjes kuadër.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambjentet e qendrës sociale “Shtëpia e Përbashkët” Berat.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Ofrimi i një vakti të ngrohtë ushqimor për kategorinë e njerëzve në nevojë nga e hëna në të premte.

Detyrat:

Të gjithë artikujt ushqimorë që do të përdoren për gatim do të jenë të cilësisë së parë, të freskëta, sipas specifikimeve teknike për lëndët e para të përcaktuara në këtë dokument.

Ushqimi të jetë i gatuar në çast, racioni ditor duhet të përmbajë sasi të duhura të artikujve sipas listë menusë javore, ushqimi të shpërndahet i ngrohtë sipas orareve të përcaktuara nga Administrata e Qendrës Sociale.

Në asnjë rast nuk do të lejohet zëvendësimi i artikujve ushqimorë, që janë përcaktuar në normën bazë të ushqimit, me përjashtim të rasteve të fatkeqësive natyrore apo të fuqisë madhore.

Personeli që do të realizojë procesin e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit, të ketë kualifikimin e nevojshëm profesional, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore.

Shpërndarja: Ushqimi duhet të vijë nga e hëna në të premte në Ambjentet e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ofrimi i shërbimeve do të kryhet në ambientet e Qendrës sociale “Shtëpia e Përbashkët” Berat.”

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) në është i regjistruar regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; 77.090,4 (shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë presje katër) lekë.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë, kategoria II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Në rast se vjen si bashkim operatorësh këtë licencë duhet ta paraqesin të dy operatorët ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratës së xhiros mesatare vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2022; 2023; 2024), e cila duhet të jetë në një vlerë jo më pak se **1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekë**.

Për të provuar xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2022; 2023; 2024), operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga Dega e Tatim Taksave, ose kopje të bilancit financiar të 3 (tre) viteve të fundit (2022; 2023; 2024), të certifikuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përlogaritur të fondit limit.
 - a. Kur shërbimet e mëparshme, të ngjashme, janë realizuar me institucione shërbimeve të furnizuara shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasitë.
 - b. Kur shërbimet e mëparshme, të ngjashme, janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të furnizuara.
2. Operatori ekonomik të jetë i pajisur me Çertifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore ISO 22000:2018, ose ekuivalente me to.
3. Çertifikatë e menaxhimit për sigurinë ushqimore sipas konformitetit me standartet evropiane **HACCP**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën **HACCP**).
4. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 1 ambient ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Për të plotësuar këtë pikë operatori ekonomik duhet të paraqesë:
 - a) Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose marrjen me qera të këtij ambienti për aktivitetin e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit (katering).
 - b) Leje higjeno - sanitare për objektin në fjalë.
5. Dokumentacion nga Operatori ekonomik se disponon në pronësi ose me qera një automjet transporti të përshtatshëm ATV (frigorifer) për transportimin e mallrave, automjet të përshtatshëm ATP (jo frigorifer) për transportimin e mallrave, në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara dhe që plotësojnë kushtet higjeno sanitare për të gjithë periudhën e realizimit të shërbimit objekt prokurimi, shoqëruar me:
 - a) Leje qarkullimi;
 - b) Çertifikatë të kontrollit teknik (e vlefshme);
 - c) Siguracion të mjetit (e vlefshme);
 - d) Akt miratimi higjeno – sanitar për mjetin.
6. Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.

a) Për këtë duhet të paraqesi vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga Autoritet në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

b) Operatori ekonomik i shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës ka për detyrim të paraqesi dokumentacion provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore.

7. Deklaratë nga Administratori i shoqërisë se në stafin e tij janë të punësuar minimalisht 3 persona nga të cilët: 1 Kuzhinier ; 1 ndihmës /kuzhinier ; 1 punonjës shërbimi/ shofer të nevojshëm për realizimin e shërbimit të ushqimit për gjithë periudhën e ofrimit të shërbimit shoqëruar me kontratat e punës të vlefshme për të tre punonjësit; dëshmitë ose çertifikatë kualifikimi përkatëse për kuzhinierin dhe punonjësin e shërbimit/shoferin si dhe të tre punonjësit të jenë të pajisur me librezë shëndetësore.

Nr.	Personeli	Sasia
1	Kuzhinier	1
2	Ndihmes Kuzhinier	1
4	Punonjës shërbimi/shofer	1
Total		3

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

